

# **ALEAT Shpk**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017  
(me Raportin e audituesve të pavarur)**

---

# Përmbajtja

	<u>Faqja</u>
Raporti i Audituesve të Pavarur	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve te parasë	4
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare	5-27

---



KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri  
Telefon +355(4)2274 524  
al-office@kpmg.com  
kpmg.com/al

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Ortakët e Aleat Shpk

### *Opinionit*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Aleat Shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, si dhe të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### *Baza për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit tonë ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA-s), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor, dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa si dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA-s.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



### *Informacione të tjera*

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen në Raportin e Drejtimit Viti 2017 drejtuar Bordit të Drejtorëve, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe në këtë mënyrë, të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose nëse duket se janë me anomali materiale.

Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë na kërkohet që ta raportojmë këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar për këto informacione.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, për të dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për të përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


### *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

  
Fatos Beqja  
Auditues Ligjor  
KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 9 mars 2018

# ALEAT Shpk

## Pasqyra e pozicionit financiar

(shuma në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>Aktive</b>			
Aktivitet e patrupëzuara	7	774,602,827	855,310,669
Tatimi i shtyrë	24	39,904,751	49,690,546
<b>Aktive afatgjata</b>		<b>814,507,578</b>	<b>905,001,215</b>
Inventarë	8	275,091,472	251,079,659
Llogari të arkëtueshme	9	238,717,820	231,971,484
Parapagime dhe të tjera për t'u arkëtuar	10	5,680,012	6,017,326
Mjete monetare dhe ekuivalentë	11	541,904,650	895,533,771
<b>Aktive afatshkurtra</b>		<b>1,061,393,954</b>	<b>1,384,602,240</b>
<b>Total i aktiveve</b>		<b>1,875,901,532</b>	<b>2,289,603,455</b>
<b>Detyrime dhe kapitali</b>			
Kapitali i paguar	12	619,750,000	619,750,000
Fitimi i mbartur		735,918,430	1,093,079,840
<b>Total i kapitalit</b>		<b>1,355,668,430</b>	<b>1,712,829,840</b>
Provizione	13	55,000,000	47,299,720
<b>Detyrime afatgjata</b>		<b>55,000,000</b>	<b>47,299,720</b>
Llogari të pagueshme	14	117,359,101	145,465,402
Të tjera detyrime	15	34,062,666	43,084,611
Tatim fitimi i pagueshëm	24	15,130,246	6,977,986
Të ardhura të shtyra	16	188,355,642	191,044,530
Tarifë konçesioni e pagueshme	17	110,325,447	142,901,366
<b>Deyrime afatshkurtra</b>		<b>465,233,102</b>	<b>529,473,895</b>
<b>Total i detyrimeve</b>		<b>520,233,102</b>	<b>576,773,615</b>
<b>Total i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>1,875,901,532</b>	<b>2,289,603,455</b>

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për publikim nga drejtimi i ALEAT Shpk më 9 mars 2018 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:

Jean-Alain JOUAN  
Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv

Elton Toro  
Drejtori i kontrollit financiar

Shënimet në faqet 5 deri në 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# ALEAT Shpk

## Pasqyra e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(shuma në Lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
		2017	2016
Të ardhura	18	2,226,713,552	2,889,623,498
Të ardhura të tjera	19	3,999,980	2,745,810
Lëndë të para	20	(649,373,073)	(841,335,961)
Shpenzime konçesioni	17	(110,325,447)	(142,901,366)
Shpenzime personeli	21	(337,445,495)	(311,046,126)
Furnizime dhe shërbime	22	(308,628,179)	(340,674,092)
Amortizimi	7	(164,165,549)	(122,168,754)
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	9	-	(133,956)
Ndryshime në provizion	13	(7,700,280)	-
<b>Rezultati nga veprimtaritë operative</b>		<b>653,075,509</b>	<b>1,134,109,053</b>
Të ardhura financiare		142,032	1,055,220
Shpenzime financiare		(9,986,718)	(21,274,549)
<b>Shpenzime financiare neto</b>	23	<b>(9,844,686)</b>	<b>(20,219,329)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>643,230,823</b>	<b>1,113,889,724</b>
Tatimi mbi fitimin	24	(100,392,233)	(170,814,101)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>542,838,590</b>	<b>943,075,623</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>542,838,590</b>	<b>943,075,623</b>

Shënimet në faqet 5 deri në 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# ALEAT Shpk

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shuma në Lek)

	Kapitali i paguar	Fitimi i mbartur	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2016</b>	<b>619,750,000</b>	<b>1,385,524,217</b>	<b>2,005,274,217</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>			
Fitimi i vitit	-	943,075,623	943,075,623
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>943,075,623</b>	<b>943,075,623</b>
<b>Transaksionet me ortakët e shoqërisë</b>			
<b>Kontribute dhe shpërndarje</b>			
Dividendi	-	(1,235,520,000)	(1,235,520,000)
<b>Totali i transaksioneve me ortakët e Shoqërisë</b>	<b>-</b>	<b>(1,235,520,000)</b>	<b>(1,235,520,000)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>619,750,000</b>	<b>1,093,079,840</b>	<b>1,712,829,840</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>619,750,000</b>	<b>1,093,079,840</b>	<b>1,712,829,840</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>			
Fitimi i vitit	-	542,838,590	542,838,590
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>542,838,590</b>	<b>542,838,590</b>
<b>Transaksionet me ortakët e shoqërisë</b>			
<b>Kontribute dhe shpërndarje</b>			
Dividendi	-	(900,000,000)	(900,000,000)
<b>Totali i transaksioneve me ortakët e Shoqërisë</b>	<b>-</b>	<b>(900,000,000)</b>	<b>(900,000,000)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>619,750,000</b>	<b>735,918,430</b>	<b>1,355,668,430</b>

Shënimet në faqet 5 deri në 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



# ALEAT Shpk

## Pasqyra e flukseve monetare

(shuma në Lek)

		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
	Shënime	2017	2016
<b>Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
Fitimi i vitit		542,838,590	943,075,623
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	7	164,165,549	122,168,754
Fitimi neto nga shitja e aktiveve të patrupëzuara	19	(348,370)	(136,756)
Tarifa e konçesionit	17	110,325,447	142,901,366
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	9	-	133,956
Ndryshime në provizion	13	7,700,280	-
Të ardhura nga interesi	23	(142,032)	(1,055,220)
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	24	100,392,233	170,814,101
		<b>924,931,697</b>	<b>1,377,901,824</b>
<i>Ndryshime në:</i>			
- Inventarë		(24,011,813)	172,855,372
- Llogari të arkëtueshme		(6,746,336)	126,685,538
- Parapagimet dhe të tjera për t'u arkëtuar		337,314	142,613,577
- Llogari të pagueshme		(28,106,301)	(136,442,629)
- Detyrimet e tjera		(9,021,945)	(15,438,087)
- Të ardhurat e shtyra		(2,688,888)	(1,147,218)
<b>Mjete monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>854,693,728</b>	<b>1,667,028,377</b>
Pagesa e tarifës së konçesionit	17	(142,901,366)	(174,312,037)
Tatimi fitimi i paguar	24	(82,454,178)	(203,955,274)
<b>Mjete monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>629,338,184</b>	<b>1,288,761,066</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese</b>			
Arkëtime nga shitja e aktiveve	7,19	535,578	136,756
Blerje e aktiveve të patrupëzuara	7	(83,644,915)	(417,002,025)
Interesi i arkëtuar	23	142,032	1,055,220
<b>Mjete monetare neto nga veprimtaritë investuese</b>		<b>(82,967,305)</b>	<b>(415,810,049)</b>
<b>Mjete monetare nga veprimtaritë e financimit</b>			
Dividendi i paguar	12	(900,000,000)	(1,235,520,000)
<b>Mjete monetare neto nga veprimtaritë e financimit</b>		<b>(900,000,000)</b>	<b>(1,235,520,000)</b>
Pakësimi neto i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to		(353,629,121)	(362,568,983)
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to më 1 janar		895,533,771	1,258,102,754
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë me to më 31 dhjetor</b>	11	<b>541,904,650</b>	<b>895,533,771</b>

Shënimet në faqet 5 deri në 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 1. Shoqëria raportuese

#### a) Informacion i përgjithshëm mbi Shoqërinë

ALEAT Shpk ("ALEAT "ose "Shoqëria"), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më 18 gusht 2008 me NIPT K82018015V.

Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në zbatimin e Marrëveshjes së Shërbimit të Konçesionit ('Marrëveshja e Konçesionit') nënshkruar me Qeverinë Shqiptare ('Autoriteti') për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumentave të identifikimit dhe pasaportave elektronike dhe në aktivitete të tjera të lidhura me zbatimin e marrëveshjes së konçesionit si: rikonstruksion, shërbime të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit, themelimin dhe administrimin e një rrjeti zyresh të ngritura për pranimin e aplikimeve për karta identiteti dhe pasaporta, përpunimin e të dhënave, printimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave, etj. Marrëveshja e Konçesionit u zgjat deri më 31 korrik 2023, nëpërmjet një Amendimi të firmosur nga Qeveria shqiptare më 19 mars 2013, e cila ka hyrë në fuqi me 31 maj 2013 ("Data Efektive").

Ortakët e Shoqërisë dhe pjesëmarrjet e tyre respektive janë si më poshtë:

Ortakët	Në %	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Idemia Identity & Security (më parë e njohur si Safran Identity & Security)	75.00	75.00
Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndërmarrjeve ("FSHAN")	25.00	25.00
	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

Përmes një transaksioni të përfunduar më 31 maj 2017, grupi i mëparshëm i shoqërisë, Safran Identity & Security (i njohur më parë si Morpho) u shit nga SAFRAN Group tek Advent International Corporation që e bashkoi atë me Oberthur Technologies duke krijuar më 4 tetor 2017, një lider botëror në teknologji, të njohur si Idemia Identity & Security. Sipas kushteve të Marrëveshjes së Konçesionit, FSHAN dhe Idemia Identity & Security do të vazhdojnë të jenë ortakët e vetëm të Shoqërisë përgjatë periudhës së konçesionit dhe në rast transferimi të kuotave ndërmjet njëri-tjetrit, Idemia Identity & Security do të zotërojë të paktën 50.1% të kuotave me të drejtë vote. Adresa e regjistruar e shoqërisë është në rrugën "Xhanfize Keko" (ish Tipografia Ushtarake), Tiranë, Shqipëri dhe ka 269 punonjës më 31 dhjetor 2017 (2016: 254 punonjës).

#### b) Marrëveshja e Konçesionit – kushte të rëndësishme

##### *Përshkrim*

Në përputhje me Ligjin Nr. 9663, datë 18 dhjetor 2006 "Mbi konçesionet" dhe Ligjin Nr. 8952, datë 10 tetor 2002 "Mbi pajisjen me pasaporta të qytetarëve shqiptarë" ashtu si dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 541, date 26 korrik 2006; Nr. 27, datë 19 janar 2007; Nr. 253, datë 27 prill 2007; Nr. 715, datë 6 nëntor 2007; Nr. 196, datë 13 prill 2007 dhe Nr. 525, datë 8 gusht 2007 në lidhje me pajisjen me mjete identifikimi dhe pasaporta të qytetarëve shqiptar, Qeveria shqiptare përfaqësuar nga Ministria e Brendshme ('Autoriteti') lidhën një Marrëveshje Konçesionari me Shoqërinë (Konçesionari) me 27 korrik 2008.

Në përputhje me kushtet e caktuara në Marrëveshje, Ministria e Brendshme financon dhe autorizon Konçesionarin për të ofruar shërbimet e dizenjimit, themelimit, zhvillimit, implementimit dhe operimit të sistemit për ofrimin e kartave të identitetit dhe pasaportave qytetarëve dhe/ose rezidentëve të tjerë në Shqipëri.

*Kushte të rëndësishme që mund të prekin shumën, kohëzgjatjen, dhe sigurinë e flukseve monetare:*

Çmimi aktual për kartat e identitetit dhe pasaportat, kartat e identitetit për emigrantët, kartat e identitetit që lëshohen nga zyrat e aplikimit në Ambasadë, si dhe dokumentet e shërbimit me procedurë të përshpejtuar, është i përcaktuar nga Autoriteti. Duke filluar nga 1 janari 2015, të gjitha çmimet për kartat e identitetit dhe pasaportat janë rritur me 25%. Të gjitha çmimet e tjera për aplikimet nëpër ambasadë dhe ato brenda vendit duke përfshirë këtu aplikimet për procedurë të përshpejtuar janë rritur me 20%.

# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 1. Shoqëria raportuese (vazhdim)

#### b) Marrëveshja e Konçesionit – kushte të rëndësishme (vazhdim)

##### *Dorëzimi i konçesionit*

Pas përfundimit të Marrëveshjes së Konçesionit, Shoqëria duhet të bëjë dorëzimin e ambjentëve të Konçesionit tek Autoriteti. Shoqëria duhet të transferojë tek Autoriteti çdo të drejtë apo titull në lidhje me ambjentet e Konçesionit dhe të gjithë aktivet e dizenuara dhe të përdorura gjatë periudhës së konçesionit. Shoqëria, për një vit pas përfundimit të Periudhës së Konçesionit, do të ofrojë shërbimin e garancisë së Sistemit, sipas kushteve të paracaktuara në marrëveshjen e konçesionit dhe pa asnjë pagesë shtesë për Autoritetin.

Shoqëria duhet të sigurojë që të gjitha aktivet, të drejtat, pronat dhe zërat e tjerë referuar në këtë pikë të Marrëveshjes, të cilat do t'i transferohen Autoritetit, duhet të jenë në kushte të mira pune dhe të riparuar mirë në mënyrë që sistemi të ketë mundësi të funksionojë normalisht, për tre vite të tjera pa lindur nevoja për të zëvendësuar ndonjë pjesë, me përjashtim të Materialeve të Konsumit, dhe pa përdorur asnjë detyrim garancie përtej periudhës një vjeçare pas Periudhës së Konçesionit.

#### 2. Bazat e kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Detajet e politikave kontabël të shoqërisë përfshihen në shënimin 5.

#### 3. Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek shqiptar ('Lek'), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 4. Vlerësime dhe gjykime

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi ka kryer gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në mënyrë prospektive.

##### (a) Gjykimet

Informacioni mbi gjykimet e kryera në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara është përfshirë në shënimet e mëposhtme:

- Shënimin 13 - njohja dhe matja e detyrimit kontraktual për shërbimin e mirëmbajtjes;
- Shënimin 7 – identifikimi i NJGJP-ve

##### (b) Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit

Informacioni mbi pasiguritë e vlerësimit që kanë një efekt të rëndësishëm në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve të njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në paragrafët e mëposhtëm:

###### (i) Tatimi mbi fitimin

Drejtimi, pavarësisht nga pasiguria e mjedisit tatimor shqiptar dhe legjislacioni ekzistues në fuqi, beson se llogaritja e tatimit mbi të ardhurat është e përshtatshme për të gjitha vitet e hapura tatimore bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimin e ligjit tatimor dhe përvojën e mëparshme dhe se çdo auditim nga tatimet në të ardhmen nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në pozicionin financiar të Shoqërisë, në rezultatet e operacioneve ose në flukset e parasë. Gjithsesi, duke u bazuar në natyrën e ligjit mbi tatimin e të ardhurave, praktikën dhe udhëzimet përkatëse nuk është e mundur, që të jemi të sigurt se pozicioni ligjor i tatimit mbi të ardhurat do mbetet i pandryshuar nga autoritetet tatimore (shih Shënimin 24).

###### (ii) Amortizimi i aktiveve të patrupëzuara

Amortizimi i aktiveve të patrupëzuara llogaritet me metodën lineare bazuar në kohëzgjatjen e Marrëveshjes së Konçesionit.

Skema e amortizimit të aktiveve të patrupëzuara të mbartura nga periudhat e mëparshme është rishikuar në mënyrë që të reflektohet jetëgjatësia për përdorim të aktiveve të patrupëzuara në datën e përfundimit të konçesionit (shih Shënimin 7).

# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 4. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

#### (b) Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit (vazhdim)

(iii) Provizionet

Provizioni për shërbimet e mirëmbajtjes që Shoqëria duhet t'i japë Autoriteteve pas datës së përfundimit pa kompensim shtesë është i bazuar në vlerësimin e bërë nga të dhënat historike të lidhura me shërbime të mirëmbajtjeve të ngjashme (shih Shënimin 13).

### 5. Politikat kryesore kontabël

Politikat e mëposhtme kontabël janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme tek të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### (a) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

#### (b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhë funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në valutë të huaj në datën e raportimit rivlerësohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur vlera drejtë është përcaktuar. Zërat jo-monetar që vlerësohen bazuar në koston historike në monedhë të huaj përkthehen me kursin e datës së transaksionit. Diferencat në monedhë të huaj që vijnë nga rikonvertimi përgjithësisht njihen si fitim ose humbje.

#### (c) Instrumenta financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare jo-derivative në kategorinë e huave dhe llogarive të arkëtueshme dhe detyrimet financiare jo derivative në detyrime të tjera financiarë.

(i) *Instrumentet financiare jo-derivative – Njohja dhe çregjistrimi*

Shoqëria njeh huatë dhe të arkëtueshmet tregtare fillimisht në datën kur ato krijohen. Të gjithë aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit kur Shoqëria bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria ç'regjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë të aktivit financiar janë transferuar ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara, që kualifikohet për ç'regjistrim, i mbajtur ose i krijuar nga Shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Shoqëria ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, anuluar apo kanë skaduar.

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe synon t'i shlyejë ato në baza neto ose të njohë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 5. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (c) Instrumenta financiare (vazhdim)

##### (ii) Instrumentat financiare jo-derivative - Matja

Huatë dhe të arkëtueshmet tregtare maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksioneve që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e saj. Pas njohjes fillestare me vlerë të drejtë, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejtë. Pas njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### (d) Aktive të patrupëzuara

##### (i) Modeli i aktiveve të patrupëzuara të Konçesionit

Sipas Marrëveshjes së Konçesionit, Shoqëria duhet të pajisë me karta identiteti dhe pasaporta të gjithë shtetasit Shqiptar. Autoriteti kontrollon dhe rregullon shërbimet që Shoqëria ofron, ndaj kujt i ofron dhe me çfarë çmimi. Autoriteti gjithashtu kontrollon çdo interes të rëndësishëm në infrastrukturën e dhënë Shoqërisë ose të blera nga kjo e fundit për qëllime të ofrimit të shërbimeve sipas Marrëveshjes së Konçesionit. Meqënëse Marrëveshja e Konçesionit plotëson përkufizimin e marrëveshjes së konçesionit sipas KINRF 12 rrjedhimisht Shoqëria ka aplikuar kërkesat e KINRF 12 mbi këtë transaksion.

Shoqëria ka zbatuar modelin e aktiveve të patrupëzuara sipas KINRF 12 në lidhje me të drejtën e saj për të ngarkuar përdoruesit e shërbimeve publike të mëposhtme:

- Pajisjen me karta identiteti dhe pasaporta në Republikën e Shqipërisë sipas Marrëveshjes së Konçesionit,
- Pajisjen me Dokumenta Identifikimi në Zyrat e Aplikimit, në zyrat konsullore/ambasadat e Republikës së Shqipërisë në vëndet e huaja sipas Amendimit,
- Ofrimin e Shërbimeve me Proçedurë të Përsheptuar sipas Amendimit
- Ofrimin e Shërbimeve të Identitetit Dixhital dhe ndërtimin e platformës E-Trust.

Shoqëria njuh një aktiv të patrupëzuar në masën e të drejtës së fituar për ngarkimin e përdoruesve të shërbimit publik. E drejta për të ngarkuar përdoruesit e shërbimit publik nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të marrë të holla, sepse shumat janë të kushtëzuara në masën që publiku përdor shërbimin.

##### (ii) Makineri dhe pajisje të blera, rinovimet dhe të tjera shpenzime

Aktivet e patrupëzuara përfshijnë vlerën e paguar për pajisjet e blera dhe për rinovimet e aktiveve të dhëna nga Autoriteti. Shpenzimet e tjera në lidhje me aktivet e patrupëzuara, që rezultojnë nga Marrëveshja e Konçesionit njihen në shumën e mbartur të aktiveve të patrupëzuara.

##### (iii) Njohja dhe matja

Aktivet e patrupëzuara maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo zhvlerësim të akumuluar.

##### (iv) Shpenzimet pasuese

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm kur rritin përfitimet e ardhshme ekonomike të përfshira në aktivin specifik me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në fitim ose humbje si të ndodhura.

# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 5. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (d) Aktive të patrupëzuara (vazhdim)

##### (v) Amortizimi

Amortizimi llogaritet të shlyejë koston e aktiveve të patrupëzuara duke ulur vlerat e tyre të mbetura të vlerësuara duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar dhe përgjithësisht njihet në fitim ose humbje. Aktivet e patrupëzuara kanë një jetë të dobishme të përcaktuar e cila përfundon në fund të Marrëveshjes së Konçesionit që është data 31 korrik 2023. Jetët e dobishme të përlllogaritura për periudhën aktuale janë si më poshtë:

	<u>Investime të mbartura</u>	<u>Investime të reja</u>
<i>Përmirësime në qiramarrje</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>
<i>Shpenzime rinovimi</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>
<i>Program Kompjuterik</i>	<i>Amortizuar plotësisht</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>
<i>Makineri dhe Pajisje</i>	<i>Amortizuar plotësisht</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>
<i>Mobilje dhe të tjera</i>	<i>Amortizuar plotësisht</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>
<i>Pajisje IT dhe pajisje zyre</i>	<i>Amortizuar plotësisht</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>
<i>Automjete</i>	<i>Amortizuar plotësisht</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>
<i>Të tjera jo-materiale</i>	<i>Amortizuar plotësisht</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>
<i>Platforma E-Aleat</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>	<i>Periudha e konçesionit</i>

Metoda e amortizimit dhe jeta e dobishme e aktiveve rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

#### (e) Inventarët

Inventarët paraqiten me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarit bazohet në metodën mesatare të koston. Vlera neto e realizueshme është çmimi fiks i shitjes siç është përcaktuar në Marrëveshjen e Konçesionit duke i zbritur shpenzimet variabël të shitjes të aplikuar.

#### (f) Zhvlerësimi

##### (i) Aktive financiare

Aktivitet financiar vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive të zhvlerësimit. Evidencat objektive përfshijnë: dështim ose shkelje nga debitori, treguesit se debitori do të shpallë falimentin, ndryshime të pafavorshme në statusin e pagesës së debitorit dhe të dhënat të vëzhgueshme që tregojnë se ka një ulje të matshme në flukset e pritshme të mjeteve monetare nga aktivitet financiar.

Shoqëria konsideron evidencë të zhvlerësimit për këto aktive si në një aktiv individual edhe në nivel kolektiv. Të gjitha aktivitet e rëndësishme individuale vlerësohen individualisht për zhvlerësim. Ato që nuk janë të dëmtuara vlerësohen kolektivisht për çdo dëmtim që ka ndodhur, por që ende nuk është identifikuar në mënyrë individuale. Aktivitet që nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen kolektivisht për zhvlerësim. Vlerësimi kolektiv kryhet duke grupuar së bashku aktivitet me karakteristika të ngjashme të rrezikut.

Në vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv, shoqëria përdor informacion historik mbi kohën e rikuperimit dhe shumën e humbjes së shkaktuar, dhe bën një rregullim nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla, që humbjet aktuale ka mundësi të jenë më të mëdha ose më të vogla sesa sugjerohet nga tendencat historike .

Një humbje nga zhvlerësimi llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël neto të një aktivi dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të parashikuara, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitet. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zbritjeje. Kur shoqëria konsideron që nuk ekziston prespektivë reale mbi rikuperimin e aktivitet, shumat respektive fshihen nga kontabiliteti. Në qoftë se shumata e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet më pas, dhe zbritja lidhet objektivisht me një ngjarje pas njohjes së zhvlerësimit, atëherë shumata e mëparshme e humbjes nga zhvlerësimi rimerret në fitim-humbje.

# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 5. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (f) Zhvlerësimi (vazhdim)

##### (ii) Aktive jo-financiare

Në çdo datë raportimi, Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare (përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra) për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Për testimin e zhvlerësimit, aktivet grupohen në grupin më të vogël të aktiveve që mund të gjenerojë flukse hyrëse nga përdorimi i tyre i vazhdueshëm dhe që janë të pavarura nga flukset hyrëse të aktiveve ose njërive gjeneruese të parave (NJGJP-ve). Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose NJGJP-ja është më e madhja midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Vlera në përdorim bazohet në flukset e parashikuara të parasë së gatshme, të skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë si dhe rreziqet specifike të aktivitetit ose NJGJP-së.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose NJGJP-je tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Ato shpërndahen në aktivet në NJGJP në baza proporcionale për të zvogëluar vlerat e tyre kontabël.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm në atë masë që vlera kontabël neto e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël neto që do të ishte përcaktuar, neto nga zhvlerësimi ose amortizimi, nëse nuk ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

#### (g) Përfitimet e punonjësve

##### *Përfitimet afatshkurtra të punonjësve*

Përfitimet afatshkurtra të punonjësve njihen si shpenzim kur jepet shërbimi përkatës. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet nëse Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimit të mërparsëm të ofruar nga punonjësi dhe nëse detyrimi mund të vlerësohet me besueshmëri.

##### *Pensionet e detyrueshme*

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, paguan kontributet në emër të vet dhe në emër të punonjësve të saj sipas legjislacionit lokal. Shpenzimet e lidhura me kontributet e bëra në emër të shoqërisë regjistrohen si fitim ose humbje kur ndodhin.

##### *Plani i përcaktuar i kontributeve*

Detyrimet për kontributet në planet e kontributeve të përcaktuara shpenzohen ashtu si shërbimi i dhënë përkatës. Kontributet e parapaguara njihen si një aktiv në masën që është në dispozicion një rimbursim i parave ose një ulje në pagesën e ardhshme.

#### (h) Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin dhe shuma e detyrimit mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Provizionet llogariten duke skontuar vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhshme para tatimit, që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, dhe rrezikun specifik ndaj detyrimit. Zhvendosja e zbritjes njihet si kosto financiare. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është akoma e mundur, që të kërkohet një rrjedhje e burimeve duke personifikuar burime ekonomike për shlyerjen e detyrimeve, provizionet anulohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet për të cilat njihen fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhshme operative.

##### *Shërbimet e mirëmbajtjes (ose Detyrimet pas Dorëzimit)*

Shërbimi i mirëmbajtjes lidhet me shërbimin e garancisë që do të ofrohet nga shoqëria për një vit, pas përfundimit të periudhës së koncesionit, pa pagesë shtesë për Autoritetin (shih notën 1(b)).

# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 5. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (i) Njohja e të ardhurave

*Të ardhurat nga Marrëveshja e Konçesionit*

Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet kryesore të pronësisë i janë transferuar konsumatorit, rikuperimi i shumës është i mundshëm, shpenzimet e lidhura dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të vazhdueshme të Drejtimit në mallrat dhe të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme. Të ardhurat maten neto, të zbritura nga kthimet, uljet tregtare dhe zbritjet nga volumi. Koha e transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve ndryshon në varësi të kushteve të veçanta të marrëveshjes së shitjes.

Të ardhurat e Shoqërisë përbëhen nga shitja e kartave të identitetit dhe pasaportave me çmimin e caktuar dhe kontrolluar nga Autoriteti, si edhe nga përdorimi elektronik i kartave të identitetit autentike. Të ardhurat nga shitja e kartave të identitetit dhe pasaportave njihen kur kartat e identitetit apo pasaportat u vihen në dispozicion zyrave të dedikuara (OSC, PSH, zyrat e konsullatave). Pjesa e shumës së marrë nga kartat e identitetit dhe pasaportat e prodhuara por ende të padorëzuara deri në fund të vitit, njihet si e ardhur e shtyrë në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### (j) Të ardhurat dhe kostot financiare

E ardhura ose shpenzimi nga interesat njihet duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet në monedhë të huaj raportohen në baza neto ose si të ardhurave ose si shpenzim në varësi të faktit nëse lëvizjet në monedhë të huaj janë në një pozicion fitimi neto ose humbjeje neto.

#### (k) Qiratë

Pagesat e bëra sipas qirasë operative njihen në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e marrë nga qiraja janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë, përgjatë afatit të qirasë.

Aktivet që lidhen më këto qira klasifikohen si qira operative dhe nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë.

#### (l) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në fitim ose humbje përveç pjesës, që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesat dhe gjrobat që lidhen me tatimin mbi të ardhurat, duke përfshirë trajtimet jo të sigurtat tatimore, trajtohen sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara.

##### (i) *Tatimi aktual*

Tatimi aktual përbën tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet mbi fitimin ose humbjen e tatueshme të vitit dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm ose arkëtueshëm për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasigurinë që lidhen me tatim fitimin, nëse ka të tilla. Ai llogaritet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit.

Tatim fitimi aktual i pagueshëm ose arkëtueshëm kompensohet vetëm në qoftë se përmbushen kritere të caktuara.



# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 5. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (I) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

##### (ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet lidhur me diferencat e përkohëshme midis vlerës së mbetur të aktiveve ose te detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe të vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen në bazë të ndryshimit të diferencave të përkohshme të tatueshme. Nëse shuma e diferencave të përkohshme të tatueshme është e pamjaftueshme për të njohur në tërësi një aktiv tatimor të shtyrë, atëherë konsiderohen fitimet e ardhshme të tatueshme, të rregulluara për anulimet e diferencave të përkohshme ekzistuese, bazuar në planet e biznesit. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur, që përfitimi përkatës tatimor të realizohet; reduktime të tilla kthehen kur përmirësohet probabiliteti i fitimeve të tatueshme në të ardhmen.

Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën që është bërë e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme të jenë në dispozicion kundrejt të cilave ato mund të përdoren.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të nxjerra në mënyrë thelbësore në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si shoqëria pret, në datën e raportimit, të rekuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta.

Aktivi tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyrë vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.

### 6. Standarde dhe interpretime të reja ende të pa adoptuara

Një seri standardesh të reja, rishikime dhe interpretime të standardeve ekzistuese do bëhen efektive për periudhat që fillojnë pas datës 1 janar 2017 dhe zbatimi i hershëm lejohet por nuk është zbatuar nga Shoqëria në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Ato të cilat janë më të rëndësishme për shoqërinë, paraqiten si më poshtë:

#### a) SNRF 9 Instrumentet financiare

SNRF 9, i publikuar Më korrik 2014 zëvendëson interpretimet ekzistuese në SNK 39 Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja. SNRF 9 përfshin interpretime të rishikuara në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, përfshirë një model të ri të humbjes së pritur të kreditit për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesat e reja të kontabilitetit të mbrojtjes. SNRF 9 është efektive për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më ose pas 1 janar 2018 me mundësinë e aplikimit të mëhershëm.

Edhe pse nuk ka përfunduar plotësisht vlerësimin fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 9 në pasqyrat financiare të Shoqërisë, Drejtimi nuk pret që standardi i ri, kur të zbatohet fillimisht, do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Bazuar në vlerësimin e saj, klasifikimi dhe matja e instrumenteve financiare, duke përfshirë edhe zhvlerësimin e njohur, nuk pritet të ketë ndryshime materiale. Megjithatë, ky vlerësim mund të ndryshojë pasi Shoqëria të finalizojë proceset dhe politikat e saj kontabël në përputhje me kërkesat e SNRF 9.

# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

*(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

### **6. Standarde dhe interpretime të reja ende të pa adoptuara (vazhdim)**

#### **b) SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët**

SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 janar 2018, duke lejuar dhe zbatimin më të hershëm. Standardi i ri zëvendëson udhëzimet ekzistuese për njohjen e të ardhurave sipas SNRF, duke përfshirë SNK 18 Të ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe KIRFN 13 Programet e Besnikërisë së Klientit. Shoqëritë do të zbatojnë një model me pesë hapa për të përcaktuar kur duhet njohur e ardhura dhe në çfarë shume. Modeli i ri saktëson që e ardhura duhet të njihet kur (ose ndërkohë që) një njësi ekonomike transferon kontrollin mbi mallrat ose shërbimet tek një klient për shumën të cilën njësi ekonomike pret të ketë të drejtën të arkëtojë. Në varësi të përmbushjes së disa kritereve, e ardhura njihet:

- përgjatë periudhës, në një mënyrë që pasqyron ecurinë e njësisë ekonomike; ose
- në një moment kohor, kur kontrolli mbi mallrat ose shërbimet i transferohet klientit.

SNRF 15 gjithashtu vendos parimet që një njësi ekonomike duhet të zbatojë për dhënien e shënimeve shpjeguese cilësore dhe sasiore, që japin informacion të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare mbi natyrën, shumën, kohën dhe pasigurinë në lidhje me të ardhurat si dhe mbi flukset monetare nga kontratat me klientët.

Megjithëse ende nuk ka përfunduar vlerësimin e tij fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 15 mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë, Drejtimi nuk pret që Standardi i ri, në momentin e zbatimit fillestar të tij, të ketë ndonjë ndikim material mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë. Koha dhe matja e të ardhurave të Shoqërisë nuk pritet të ndryshojnë me SNRF 15 për shkak të natyrës së veprimtarive të Shoqërisë dhe llojit të të ardhurave që ajo realizon.

# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 6. Standarde dhe interpretime të reja ende të pa adoptuara (vazhdim)

#### c) SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 Qiratë, KIRFN 4 *Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira*, KIS-15 *Qiratë Operative - Stimujt* dhe KIS-27 *Vlerësimi i Përmbajtjes së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje*. Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Një qiramarrës njih një aktiv për të drejtën e përdorimit që përfaqëson të drejtën e tij të përdorimit të aktivitet bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa qiraje. Ka përjashtime nga njohja për qiratë afat-shkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët. Kontabiliteti nga qiradhënësi mbetet i ngjashëm me standardin aktual – pra, qiradhënësi do të vazhdojnë të klasifikojnë qiratë si financiare ose operative. Standardi hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 duke lejuar edhe zbatim më të hershëm për njësitë ekonomike që zbatojnë SNRF 15 në ose para datës së zbatimit fillestar të SNRF 16.

Shoqëria ka kryer një vlerësim fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, por nuk ka kryer ende një vlerësim të detajuar. Ndikimi aktual i zbatimit të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara në periudhën e zbatimit fillestar do të varet nga kushtet e ardhshme ekonomike, duke përfshirë normën e huamarrjes së Shoqërisë më 1 janar 2019, përbërjen e portofolit të qirave së Shoqërisë në atë datë, vlerësimin më të fundit të Shoqërisë nëse do të ushtrojë ndonjë nga mundësitë e rinovimit të qirave si dhe shkallën në të cilën Shoqëria do të zgjedhë të përdorë lehtësitë praktike dhe përjashtimet nga njohja..

Deri më tani, ndikimi më i rëndësishëm i identifikuar është se Shoqëria do të njohë aktivitet dhe detyrimet e reja për qiratë operative të automjeteve dhe vendbanimin për stafin e jashtëm. Më 31 dhjetor 2017, pagesat e ardhshme minimale të paskontuara të qirasë operative të paluajtshme të shoqërisë për qiradhënësit ekzistuese arritën në 4 milionë lekë.

Për pagesat e paskontuara minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të pa-anulueshme më 31 dhjetor 2017 shih Notën 26.

Për më tepër, natyra e shpenzimeve që lidhen me ato qira do të ndryshojë tashmë pasi SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e njëtrajtshme të qirasë me shpenzimin e amortizimit të së drejtës së përdorimit të aktiveve me qira dhe shpenzimin e interesit mbi detyrimet e qirasë.

#### Standarde të tjera

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë:

- *Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2014-2016 - Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28;*
- *Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione (Ndryshime në SNRF 2).;*
- *Transferimi i aktiveve materiale afatgjata të investuara (Ndryshime në SNK 40);*
- *Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28);*
- *KIRFN 22 Transaksionet dhe Paradhënit në Monedhë të Huaj;*
- *KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin;*
- *Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9);*
- *Interesat Afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28);*
- *Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23);*
- *Ndryshimet, Shkurtimeve ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19)*

# ALEAT Shpk

## Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 7. Aktive të patrupëzuara

	Përmirësime të ndërtesave në përdorim	Makineri dhe Pajisje	Liçensa për Software	Përmir. të zyrave me qera	Mobilje dhe pajisje të tjera	Kompjuterat dhe pajisje zyrash	Automjete	Të tjera	Platforma E- Aleat	Aktive në Proçes	Totali
<b>Kosto</b>											
Gjendja më 1 janar 2016	195,261,283	220,584,655	2,343,067,778	525,592	37,465,239	378,573,824	13,969,088	53,811,016	195,261,283	220,584,655	2,343,067,778
Shtesa	-	-	255,480,060	-	1,661,031	9,479,200	6,523,200	-	-	-	255,480,060
Pakësime	-	-	-	-	-	(1,610,755)	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>195,261,283</b>	<b>220,584,655</b>	<b>2,598,547,838</b>	<b>525,592</b>	<b>39,126,270</b>	<b>386,442,269</b>	<b>20,492,288</b>	<b>53,811,016</b>	<b>195,261,283</b>	<b>220,584,655</b>	<b>2,598,547,838</b>
Shtesa	45,649,539	-	-	-	-	19,383,616	5,418,800	-	45,649,539	-	-
Riklasifikime	552,434	-	45,691,800	-	-	-	-	-	552,434	-	45,691,800
Pakësime	(3,350,954)	-	-	-	-	-	(5,374,280)	-	(3,350,954)	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>238,112,302</b>	<b>220,584,655</b>	<b>2,644,239,638</b>	<b>525,592</b>	<b>39,126,270</b>	<b>405,825,885</b>	<b>20,536,808</b>	<b>53,811,016</b>	<b>238,112,302</b>	<b>220,584,655</b>	<b>2,644,239,638</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>											
Gjendja më 1 janar 2016	(181,217,954)	(214,049,711)	(2,083,498,875)	(525,592)	(37,153,923)	(355,351,958)	(13,969,088)	(53,811,016)	(181,217,954)	(214,049,711)	(2,083,498,875)
Amortizimi i vitit	(1,851,868)	(3,267,471)	(71,003,361)	-	(128,656)	(4,108,702)	-	-	(1,851,868)	(3,267,471)	(71,003,361)
Pakësime	-	-	-	-	-	1,610,755	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(183,069,822)</b>	<b>(217,317,182)</b>	<b>(2,154,502,236)</b>	<b>(525,592)</b>	<b>(37,282,579)</b>	<b>(357,849,905)</b>	<b>(13,969,088)</b>	<b>(53,811,016)</b>	<b>(183,069,822)</b>	<b>(217,317,182)</b>	<b>(2,154,502,236)</b>
Amortizimi i vitit	(1,836,481)	(3,267,473)	(104,712,923)	-	(280,054)	(4,829,616)	(1,755,056)	-	(1,836,481)	(3,267,473)	(104,712,923)
Pakësime	3,163,744	-	-	-	-	-	5,374,282	-	3,163,744	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>(181,742,559)</b>	<b>(220,584,655)</b>	<b>(2,259,215,159)</b>	<b>(525,592)</b>	<b>(37,562,633)</b>	<b>(362,679,521)</b>	<b>(10,349,862)</b>	<b>(53,811,016)</b>	<b>(181,742,559)</b>	<b>(220,584,655)</b>	<b>(2,259,215,159)</b>
<b>Vlera e mbetur</b>											
Më 1 janar 2016	14,043,329	6,534,944	259,568,903	-	311,316	23,221,866	-	-	14,043,329	6,534,944	259,568,903
Më 31 dhjetor 2016	12,191,461	3,267,473	444,045,602	-	1,843,691	28,592,364	6,523,200	-	12,191,461	3,267,473	444,045,602
Më 31 dhjetor 2017	56,369,743	-	385,024,479	-	1,563,637	43,146,364	10,186,946	-	56,369,743	-	385,024,479

Për qëllimet e të testit të zhvlerësimit, drejtimi i konsideron aktivet e saj të patrupëzuara si një NJGJP, duke përfshirë platformën E-ALEAT pasi nuk mund të ndahet teknikisht dhe është pjesë e integruar e të gjithë sistemit. Drejtimi beson se hyrjet e mjeteve monetare të gjeneruara janë kryesisht të varura nga aktivet e tjera të Shoqërisë. Për më tepër, Drejtimi e konsideron rrjetin si një aktivet të vetëm dhe shërbimet e ofruara janë të integruara.

Drejtimi nuk ka identifikuar ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve të patrupëzuara dhe rrjedhimisht nuk është kryer ndonjë test për zhvlerësimin e aktiveve të patrupëzuara .

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 8. Inventarë

Inventarët më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Lëndë të para:		
Pasaporta	183,872,034	158,492,154
Karta identiteti	73,873,868	76,977,085
Fatura për Kartat identiteti dhe Pasaporta	7,466,323	4,646,941
Lexues Biometrikë	9,430,620	10,514,852
Të tjera	448,627	448,627
<b>Totali</b>	<b>275,091,472</b>	<b>251,079,659</b>

### 9. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Të arkëtueshme nga klientët	265,297,831	258,551,495
Zbritje: zhvlerësim të kërkesave për t'u arkëtuar	(26,580,011)	(26,580,011)
<b>Totali</b>	<b>238,717,820</b>	<b>231,971,484</b>

Llogaritë e arkëtueshme bruto përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Posta Shqiptare	203,938,550	208,914,050
Ministria e Punëve të Jashtme	41,922,531	30,164,983
Morpho	11,951,646	11,951,646
Institucionet shtetërore shqiptare	6,613,400	6,613,400
R&T Shpk	492,000	294,800
Dhoma e Noterëve	165,200	165,200
Proton Shpk	147,600	122,100
Të tjera për t'u arkëtuar	66,904	325,317
<b>Totali</b>	<b>265,297,831</b>	<b>258,551,496</b>

Shuma për t'u arkëtuar, individualisht e rëndësishme, prej 26,580,011 Lek konsiderohen plotësisht të zhvlerësuara duke qënë se janë më të vjetra se një vit. Një zhvlerësim i tillë është regjistruar për shumat e arkëtueshme të Morpho në vlerën 11,951,646 Lek, Postës Shqiptare në vlerën 7,043,681 Lek, Ministria e Punëve të Jashtme në vlerën 971,284 Lek dhe Institucione shtetërore shqiptare në vlerën 6,613,400 Lek. Lëvizjet në zhvlerësim të kërkesave për t'u arkëtura gjatë 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	2017	2016
Gjendja më 1 janar	26,580,011	26,446,055
Shtesat e vitit	-	133,956
Gjendja më 31 dhjetor	<b>26,580,011</b>	<b>26,580,011</b>

### 10. Parapagime dhe të tjera për t'u arkëtuar

Parapagime dhe të tjera për t'u arkëtuar më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë

	2017	2016
Parapagime për Sigurime vullnetare të shëndetit	4,122,936	3,713,074
Parapagime për aktivet e patrupëzuara	-	831,480
Parapagime për sigurim ndërtesë	75,948	515,572
Parapagime për tarifën e MPJ-së	285,000	392,084
Parapagime për sigurime nga detyrime profesionale	978,809	300,000
Parapagime për sigurimin e automjetit	199,498	245,371
Paragime të tjera	17,821	19,745
<b>Totali</b>	<b>5,680,012</b>	<b>6,017,326</b>

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 11. Mjete monetare dhe ekuivalentë

Mjete monetare dhe ekuivalente më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Mjete monetare në arkë:		
Në EUR	621,556	884,938
Në USD	158,562	141,096
Në LEK	400,736	462,163
Në GBP	49,763	46,253
	<b>1,230,617</b>	<b>1,534,450</b>
Mjete monetare në banka:		
Llogari rrjedhëse:		
Në EUR	419,608,695	732,726,076
Në USD	42,993,267	39,432,639
Në LEK	51,954,071	114,901,016
Në GBP	24,003,374	5,258,417
Në CHF	2,114,626	1,681,173
	<b>540,674,033</b>	<b>893,999,321</b>
<b>Totali</b>	<b>541,904,650</b>	<b>895,533,771</b>

### 12. Kapitali i paguar

Më poshtë është përmbledhja e kuotave të kapitalit në përfundim të secilit vit:

	31 dhjetor 2017			31 dhjetor 2016		
	Numri i kuotave	Pjesëmarrje %	Lek (në mijë)	Numri i kuotave	Pjesëmarrje %	Lek (në mijë)
Idemia						
Identity&Security (më parë njohur si Safran						
Identity&Security)	1.00	75.00	464,812.5	1.00	75.00	464,812.5
FSHAF	1.00	25.00	154,937.5	1.00	25.00	154,937.5
	<b>2.00</b>	<b>100</b>	<b>619,750</b>	<b>2.00</b>	<b>100</b>	<b>619,750</b>

Shpërndarjet e dividendit janë në vendimarrjen e ortakëve. Dividend është shpërndarë për fitimin e vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2016. Asambleja e Ortakëve, më 23 mars 2017, ka miratuar shpërndarjen e fitimit neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 si vijon:

Fitimi neto për 2016	943,075,623
Dividend të paguar në 2017	900,000,000

### 13. Provizione

Provizioni për shërbimet e mirëmbajtjes prej 55,000,000 Lek, ekuivalentë në 397,611 Euro, konsiston në provizione për shërbimet e mirëmbajtjes që Shoqëria, sipas Marrëveshjes së Konçesionit, do të kryejë në lidhje me sistemin e pajisjeve dhe softwarin e aplikimit që do t'i dorëzohen Autoritetit për një vit pas mbarimit të Kontratës, pa pagesa shtesë.

Shuma e provizioneve njihet dhe matet gjatë afatit të Marrëveshjes së Konçesionit.

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Gjendja më 1 janar	47,299,720	47,299,720
Shtesat e vitit	7,700,280	-
<b>Totali</b>	<b>55,000,000</b>	<b>47,299,720</b>

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 14. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Furnitorë	54,839,203	92,912,208
Shpenzime të përlogaritura	62,519,898	52,553,194
<b>Totali</b>	<b>117,359,101</b>	<b>145,465,402</b>

Furnitorët përbëhen si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Idemia Identity & Security ( më parë i njohur Safran Identity & Security)	37,013,170	82,127,772
Të tjera	17,826,033	10,784,436
<b>Totali</b>	<b>54,839,203</b>	<b>92,912,208</b>

### 15. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
TVSH e pagueshme	23,262,790	34,412,371
Detyrime tatimore të tjera	6,313,869	4,824,686
Detyrime tatimore lidhur me pagën	4,270,759	3,653,715
Paga të pagueshme	215,248	193,839
<b>Totali</b>	<b>34,062,666</b>	<b>43,084,611</b>

### 16. Të ardhura të shtyra

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Nga shitja e pasaportave- e re	45,050,000	45,500,000
Nga shitja e kartave të identitetit	43,905,600	43,950,000
Nga shitja e pasaportave	43,360,000	43,745,000
Nga shitja e kartave të identitetit- e re	11,293,500	10,339,500
Na shitja e pasaportave në Ambasada – e re	11,201,624	17,205,258
Nga shitja e shërbimeve ndaj Autoritetit	10,675,090	10,675,090
Nga shitja e pasaportave me proces të përshpejtuar- e re	6,510,000	3,045,000
Nga shitja e pasaportave me proces të përshpejtuar	4,912,500	4,925,000
Nga shitja e pasaportave në Ambasada- vendet në kufij	4,779,847	5,376,690
Nga shitja e pasaportave për Ambasadat e grupit të tretë- e re	3,481,603	2,934,458
Nga shitja e kartave të identitetit për Ambasadat- vendet në kufij	1,304,499	1,320,739
Nga shitja e kartave të identitetit për Ambasadat- e re	724,085	1,004,969
Nga shitja e pasaportave për Ambasadën në SHBA- e re	578,382	569,936
Nga shitja e kartave të identitetit për Ambasadat e grupit të tretë- e re	284,410	170,311
Nga shitja e pasaportave për Ambasadën në SHBA	130,213	130,213
Nga shitja e kartave të identitetit për Ambasadën në SHBA- e re	68,917	56,994
Nga shitja e pasaportave për Ambasadat e vendeve europiane	64,625	64,625
Nga shitja e kartave të identitetit për Ambasadën në SHBA	19,397	19,397
Nga shitja e kartave të identitetit për Ambasadat e vendeve europiane	11,350	11,350
<b>Totali</b>	<b>188,355,642</b>	<b>191,044,530</b>

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga të ardhurat e realizuara nga shitja e kuponave për karta identiteti dhe pasaporta tek Posta Shqiptare dhe Institucione të tjera Shtetërore Shqiptare, të cilat nuk janë prodhuar ende. Këto të ardhura do të njihen në momentin që kartat e identitetit dhe pasaportat do t'u vihen në dispozicion klientëve për tërheqje.

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 nga shërbime shtesë për Autoritetet përbëhen nga kompesime për t'u marrë nga Autoriteti për prodhimin e dokumentave të emigrantëve në vitin pasardhës.

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 17. Tarifë konçesioni e pagueshme

Tarifat e konçesionit prej 110,325,447 Lek (2016: 142,901,366 Lek) përlloriten në një masë prej 5% të xhiros totale vjetore nga shitja e kartave të identitetit, përfshirë pasaportat (përfshirë TVSH) bazuar në kushtet e Marrëveshjes së Konçesionit. Këto shuma të pagueshme ndaj Autoritetit janë përlloritur në fund të vitit dhe paguhen në vitin pasardhës sipas specifikimeve të Marrëveshjes, nëse nuk është rënë dakord ndryshe midis palëve, sipas detajimit më poshtë:

	2017	2016
Gjendja në fillim	142,901,366	174,312,037
Tarifa e konçesionit 5% e qarkullimit vjetor	110,325,447	142,901,366
Tarifa konçesioni paguar Autoritetit	(142,901,366)	(174,312,037)
<b>Gjendja në fund</b>	<b>110,325,447</b>	<b>142,901,366</b>

Tarifat e konçesionit për vitin 2016 është paguar në vitin 2017 sipas kërkesës së Autoritetit.

### 18. Të ardhura

Të ardhurat nga shitjet më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Pasaportat- E re	1,042,625,000	1,201,375,000
Pasaportat me procedurë të pershpejtuar – E re	621,015,000	898,605,000
Pasaportat e shitura nga ambasadat – E re	365,132,815	571,040,266
Kartat e identitetit – E re	185,334,000	197,871,000
Kartat e identitetit shitur nga ambasadat – E re	12,606,737	20,732,232
<b>Totali</b>	<b>2,226,713,552</b>	<b>2,889,623,498</b>

### 19. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Të ardhura nga shitja e lexuesëve të kartave	1,881,720	1,427,330
Të ardhura nga shitja e transaksioneve e-Aleat	1,769,890	1,083,824
Fitimi neto nga shitja e aktiveve të patrupëzuar	348,370	136,756
Te tjera	-	97,900
<b>Totali</b>	<b>3,999,980</b>	<b>2,745,810</b>

### 20. Lëndë të para

Lëndët e para më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Kostoja e pasaportave të shitura	533,918,544	703,497,994
Kostoja e kartave të identitetit të shitura	107,210,163	123,195,985
Kostoja e lexuesve të kartave të shitur	1,080,385	909,631
Humbje teknike në prodhim	7,163,981	13,732,351
<b>Totali</b>	<b>649,373,073</b>	<b>841,335,961</b>

### 21. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Paga	299,041,546	278,906,513
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	29,687,858	27,525,613
Sigurime shoqërore vullnetare	5,891,000	4,614,000
Sigurime shëndetësore vullnetare	2,825,091	-
<b>Totali</b>	<b>337,445,495</b>	<b>311,046,126</b>



# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 22. Furnizime dhe shërbime

Furnizime dhe shërbime më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Shërbime mirëmbajtjeje	106,864,044	116,883,503
Asistencë teknike	80,389,500	82,469,000
Komisione dhe shpenzime shitjeje	26,616,348	38,585,015
Shpenzime telekomunikacioni dhe postare	18,081,277	18,409,423
Kancelari dhe materiale	14,173,956	10,811,789
Shpenzime udhëtimi	9,130,470	9,339,560
Shpenzime për energji/ujë	7,929,924	8,795,020
Shpenzime qiraje	7,818,644	5,595,315
Shërbime konsulence	7,478,866	8,445,983
Trajnime dhe të tjera shpenzime për personelin	5,291,410	6,312,178
Sigurime	3,126,829	1,767,735
Shpenzime transporti dhe karburanti	3,020,966	3,119,918
Shpenzime taksa vendore dhe detyrime	2,266,145	589,129
Shpenzime përfaqësimi	867,638	751,605
Shpenzime komunikimi dhe reklame	147,233	2,657,955
Shpenzime të ndryshme	15,424,929	26,140,964
<b>Totali</b>	<b>308,628,179</b>	<b>340,674,092</b>

### 23. Shpenzime financiare neto

Shpenzime financiare neto për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhet si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Të ardhura financiare:		
Të ardhura nga interesi mbi depozitat	142,032	1,055,220
	<b>142,032</b>	<b>1,055,220</b>
Shpenzime financiare:		
Shpenzime interesi	(1,931,246)	(3,527,212)
Humbje neto nga kursi i këmbimit	(7,597,919)	(17,124,624)
Komisione bankare	(457,553)	(622,713)
	<b>(9,986,718)</b>	<b>(21,274,549)</b>
<b>Totali</b>	<b>(9,844,686)</b>	<b>(20,219,329)</b>

### 24. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin i njohur në fitim dhe humbje për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhet si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Shpenzime tatimi mbi fitimin aktual	90,606,438	157,122,655
Shpenzim tatimi i shtyrë	9,785,795	13,691,446
<b>Totali</b>	<b>100,392,233</b>	<b>170,814,101</b>

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 24 Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Rakordimi i normës efektive të tatim fitimit:

	2017	%	2016	%
Fitimi përpara tatimit	643,230,823		1,113,889,724	
Tatim fitimi me normën e aplikueshme	96,484,623	15.00	167,083,459	15.00
Shpenzime të panjohura	3,907,610	0.61	3,730,642	0.33
<b>Totali</b>	<b>100,392,233</b>	<b>15.61</b>	<b>170,814,101</b>	<b>15.33</b>

Parapagimet për tatimin në të ardhurat për vitin 2017 dhe 2016 kanë qenë të vlerësuara nga autoritetet tatimore në bazë të fitimit të vitit të mëparshëm siç përcaktohet nga ligjet dhe rregulloret e taksave shqiptare. Në rast të devijimeve të rëndësishme, këto vlerësime janë përshtatur sipas komunikimit me autoritetet tatimore në bazë të llogaritjeve paraprake të fitimit të vitit aktual.

Aktivitet dhe pasivitet tatimore të shtyra të njohura dhe të panjohura atribuohen si mëposhtë:

### 31 dhjetor 2017

	Balanca neto më 1 janar	Njohje si humbje ose fitim	Tatim i shtyrë aktive
Aktive të patrupëzuara	30,786,056	(12,435,842)	18,350,214
Llogari dhe të tjera të arkëtueshme	3,926,553	-	3,926,553
Llogari dhe të tjera të pagueshme	14,977,937	2,650,047	17,627,984
<b>Totali</b>	<b>49,690,546</b>	<b>(9,785,795)</b>	<b>39,904,751</b>

### 31 dhjetor 2016

	Balanca neto më 1 janar	Njohje si humbje ose fitim	Tatim i shtyrë aktive
Aktive të patrupëzuara	47,522,533	(16,736,477)	30,786,056
Llogari dhe të tjera të arkëtueshme	3,906,460	20,093	3,926,553
Llogari dhe të tjera të pagueshme	11,952,999	3,024,938	14,977,937
<b>Totali</b>	<b>63,381,992</b>	<b>13,691,446</b>	<b>49,690,546</b>

Tatimi aktual mbi të ardhurat për t'u paguar deri më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhet si më poshtë:

	2017	2016
Gjendja më 1 janar	6,977,986	53,810,605
Tatimi aktual mbi të ardhurat	90,606,438	157,122,655
Tatimi mbi të ardhurat i paguar	(82,454,178)	(203,955,274)
<b>Gjendja në fund</b>	<b>15,130,246</b>	<b>6,977,986</b>

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 25. Instrumenta financiar- Vlera drejtë dhe administrimi i rrezikut

#### (a) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Shoqëria nuk ka shpalosur vlerat e drejta për aktivet financiare dhe detyrimet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë, sepse vlera e tyre kontabël është një përafrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë.

#### (b) Administrimi i rrezikut financiar

Instrumentat financiar të përdorura nga Shoqëria e ekspozojnë atë ndaj rreziqeve të mëposhtme financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

##### (i) Struktura e administrimit të rrezikut

Drejtimi ka përgjegjësinë për themelimin dhe mbikqyrjen e kuadrit të administrimit të rrezikut për Shoqërinë.

Politikat për administrimin e rrezikut të Shoqërisë janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Shoqëria, për të vendosur kufijtë e duhur të rrezikut dhe kontrollit, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e kufijve. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut janë rishikuar rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetëve të Shoqërisë. Shoqëria, me anë të trajnimeve të saj dhe standarteve të administrimit dhe procedurave, synon të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Drejtimi monitoron pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut të shoqërisë dhe shqyrtojnë përshtatshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Shoqëria.

##### (ii) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i një humbje financiare të shoqërisë nëse një klient osë një kundërpalë e një instrumenti financiar, dështon të përmbushë detyrimet kontraktuale.

Shoqëria përcakton një kompensim për zhvlerësim, që paraqet vlerësimin e tij të humbjeve të shkaktuara në lidhje me të arkëtueshmet tregtare. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme përcaktohet në shumën që konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqet e mundshme në mbledhjen e balancave të llogarive të arkëtueshme.

Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria ka mjete monetare dhe ekuivalentë të saj në vlerën prej 541,905 mijë Lek (2016: 895,534 mijë Lek). Nga kjo vlerë, shuma prej 515,354 mijë Lek (2016: 839,049 mijë Lek) mbahet në banka dhe institucione financiare, të cilat janë klasifikuar me A, sipas agjensisë së vlerësimit Fitch, vlera prej 25,320 mijë Lek (2016: 54,950 mijë Lek) mbahet në banka dhe institucione financiare, të cilat nuk janë klasifikuar, ndërsa vlera prej 1,231 mijë Lek (2016: 1,534 mijë Lek) mbahet në arkë.

##### Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Llogari të arkëtueshme	238,717,820	231,971,484
Mjete monetare dhe ekuivalente	541,904,650	895,533,771
	<u><b>780,622,470</b></u>	<u><b>1,127,505,255</b></u>

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë për llogaritë e arkëtueshme në datën e raportimit sipas llojit të rajonit gjeografik ishte:

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Vendas	238,717,820	231,971,484
	<u><b>238,717,820</b></u>	<u><b>231,971,484</b></u>

Llogaritë e arkëtueshme në shumën 41,922,531 Lek (2016: 30,164,983 Lek) lidhen me Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila vepron si agjent nëpër ambasadat e saj dhe zyrat konsullore, kryesisht në Greqi dhe Itali.

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 25. Instrumenta financiar- Vlera drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

#### (b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

##### (ii) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Vjetërsia e llogarive dhë të tjera të arkëtueshme të cila nuk janë zhvlerësuar në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	2017	2016
Pa vonesa dhe zhvlerësime	96,927,388	109,867,429
1–30 ditë vonesë	137,133,564	118,207,242
31–90 ditë vonesë	1,822,124	3,314,563
91–120 ditë vonesë	2,029,944	227,651
Më shumë se 120 ditë vonesë	804,800	354,600
<b>Totali</b>	<b>238,717,820</b>	<b>231,971,485</b>

Drejtimi beson se shumata e pazhvlerësuar që janë me vonesë më shumë se 30 ditë, janë ende të mbledhshme në tërësi, bazuar në sjelljen historike të pagesave dhe analizën e gjerë të rrezikut të kredisë së klientit, duke përfshirë vlerësimet e kreditit të klientëve në qoftë se ato janë në dispozicion.

Analiza e cilësisë së kredisë për të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera që nuk janë as të vonuara as të zhvlerësuar është si më poshtë.

	2017	2016
Marrëdhënie tregtare me shoqërinë për 4 vjet ose më shumë	238,485,566	231,802,534
Marrëdhënie tregtare me shoqërinë për më pak se 4 vjet	232,254	168,951
<b>Total</b>	<b>238,717,820</b>	<b>231,971,485</b>

Lëvizja në kompensimin për zhvlerësim në lidhje me tregtinë dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme gjatë vitit ishte si më poshtë:

	2017	2016
Gjendja më 1 janar	26,580,011	26,446,055
Zhvlerësime të vitit	-	133,956
Gjendja më 31 dhjetor	<b>26,580,011</b>	<b>26,580,011</b>

##### (iii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një entitet mund të ndeshë në përballimin e detyrimeve të cilat lidhen me detyrime financiare që janë venodur nga mjete monetare ose aktive të tjera financiare. Qasja e shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e tij kur ato janë të detyrueshme, si në kushte normale ashtu edhe në kushte të theksuara, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

Më poshtë janë maturimet e mbetura kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare, duke përfshirë pagesat e interesit me 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	Vlera kontabël	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit
<b>31 dhjetor 2017</b>					
<i>Aktive financiare</i>					
Llogari të arkëtueshme	238,717,820	238,717,820	-	-	-
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	541,904,650	541,904,650	-	-	-
	<b>780,622,470</b>	780,622,470	-	-	-
<i>Detyrime financiare</i>					
Llogari të pagueshme	(117,359,101)	(117,359,101)	-	-	-
Të tjera detyrime	(34,062,666)	(34,062,666)	-	-	-
Tarifë konçesioni	(110,325,447)	-	(110,325,447)	-	-
	<b>(261,747,214)</b>	(151,421,767)	(110,325,447)	-	-
<b>Ekspozimi neto më 31 dhjetor 2017</b>	<b>518,875,256</b>	<b>629,200,703</b>	<b>(110,325,447)</b>	-	-

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 25. Instrumenta financiar- Vlera drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

#### (b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iii) Rrezikui likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2016	Vlera kontabël	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit
<i>Aktive financiare</i>					
Llogari të arkëtueshme	231,971,484	231,971,484	-	-	-
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	895,533,771	895,533,771	-	-	-
	<b>1,127,505,255</b>	<b>1,127,505,255</b>	-	-	-
<i>Detyrime financiare</i>					
Llogari të pagueshme	(145,465,402)	(145,465,402)	-	-	-
Të tjera detyrime	(43,084,611)	(43,084,611)	-	-	-
Tarifë konçesioni	(142,901,366)	-	(142,901,366)	-	-
	<b>(331,451,379)</b>	<b>(188,550,013)</b>	<b>(142,901,366)</b>	-	-
<b>Ekspozimi neto më 31 dhjetor 2016</b>	<b>796,053,876</b>	<b>938,955,242</b>	<b>(142,901,366)</b>	-	-

(iv) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshon në çmimet e tregut - të tilla si kurset e këmbimit dhe normat e interesit që do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumenteve financiare të saj. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është menaxhimi dhe kontrolli i ekspozimeve ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin.

*Rreziku i çmimit*

Shoqëria nuk ka ekspozim ndaj rrezikut të çmimit të kapitalit sepse nuk mban aktive financiare që përfshijnë instrumenta të kapitalit neto nga data e raportimit. Nuk është politikë e Shoqërisë të blejë instrumente të tilla dhe kështu të ekspozohet ndaj rrezikut të çmimeve, që lidhet me lëvizjet në indekset e tregut të kapitalit. Marrëveshja e Koncesionit përcakton një çmim fiks për Kartat e identitetit, Pasaportat dhe e-shërbimet siç shpjegohet në Shënimin 1 (b). Flukset hyrëse nga shërbimet elektronike, në lidhje me të cilat Shoqëria është e ekspozuar nuk janë të rëndësishme.

*Rreziku i kurseve të këmbimit*

Shoqëria operon me kurse këmbimi dhe është e ekspozuar ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit që vijnë nga ekspozimi ndaj valutave, në veçanti në lidhje me Euro dhe USD. Rreziku i kurseve të këmbimit rritet kur transaksionet financiare apo njohja e aktiveve dhe detyrimeve bëhet në një monedhë e cila nuk është monedha funksionale e Shoqërisë. Në lidhje me rrezikun e kurseve, drejtimi ka caktuar limite mbi nivelin e ekspozimit për çdo valutë dhe në total. Pozicioni monitorohet çdo muaj.

Në Amendimin e Marrëveshjes së Koncesionit, midis Shoqërisë dhe Autoritetit është rënë dakort mbi një mekanizëm kompesimi në rastet e një ndryshimi të kursit të këmbimit prej më shumë se 5% nga norma e pranuar prej 140 Lek për 1 Euro. Në rast se Leku do të zhvlerësohet ndaj Euros me të tillë luhatshmëri përgjatë vitit të fundit financiar, Shoqëria do të kompensojë Autoritetin përmes pagesës shtesë në shumën e kompensimit të qarkullimit. Pagesa e tillë do të kryhet në të njëjtën kohë me pagesën e Tarifës së Koncesionit.

Në rast të ndodhjes së ngjarjes së kundërt dhe shkaillës së njëjtë të variacionit, Shoqëria ka të drejtë të mbajë menjëherë dhe të kompensojë shumën e lartpërmendur nga tarifa e koncesionit.

Në rast se tarifa e koncesionit e pagueshme në vitin financiar nuk do të mbulojë shumën e kompensimit që duhet t'i paguhen Autoritetit, Palët do të diskutojnë dhe do të bien dakord për mjetet alternative të kompensimit të humbjeve.

Nëse ndryshimi është më i vogël ose i barabartë me 5% nuk do të ketë kompensim për humbjet.

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 25. Instrumenta financiar- Vlera drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

#### (b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iv) Rreziku i tregut

#### Rreziku ndaj ekspozimit të monedhës

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut sipas monedhave më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 ishte si më poshtë:

	Vlera kontabël	GBP	CHF	EUR	USD	Lek
<b>31 dhjetor 2017</b>						
Llogari të arkëtueshme	238,717,820	2,565,647	-	32,777,401	5,608,200	197,766,572
Mjete monetare dhe ekuivalente	541,904,650	24,053,136	2,114,627	420,230,251	43,151,829	52,354,807
Llogari të pagueshme	(117,359,101)	-	-	(44,594,391)	-	(72,764,710)
Të tjera detyrime	(34,062,666)	-	-	-	-	(34,062,666)
Tarifë konçesioni	(110,325,447)	-	-	-	-	(110,325,447)
<b>Ekspozimi Neto</b>	<b>518,875,256</b>	<b>26,618,783</b>	<b>2,114,627</b>	<b>408,413,261</b>	<b>48,760,029</b>	<b>32,968,556</b>
<b>31 dhjetor 2016</b>						
Llogari të arkëtueshme	231,971,484	2,653,058	962,304	20,393,415	5,184,921	202,777,786
Mjete monetare dhe ekuivalente	895,533,771	5,304,671	1,681,173	733,611,015	39,573,734	115,363,178
Llogari të pagueshme	(145,465,402)	-	-	(82,527,972)	-	(62,937,430)
Të tjera detyrime	(43,084,613)	-	-	-	-	(43,084,613)
Tarifë konçesioni	(142,901,366)	-	-	-	-	(142,901,366)
<b>Ekspozimi Neto</b>	<b>796,053,874</b>	<b>7,957,729</b>	<b>2,643,477</b>	<b>671,476,458</b>	<b>44,758,655</b>	<b>69,217,555</b>

Më poshtë paraqiten kurset e këmbimit kryesore të aplikuara gjatë vitit:

Lek	Kursi në datën e këmbimit		Kursi mesatar	
	2017	2016	2017	2016
1 Eur	134.15	137.37	132.95	135.23
1 USD	119.08	124.08	111.1	128.17

Varianca midis Euros dhe Lekut përgjatë vitit 2017 është më e vogël se 5%, Shoqëria nuk ka përfituar apo paguar kompesim për humbjet për/nga Autoriteti.

#### Analiza e ndjeshmërisë

Një forcim ose dobësim i Lekut, kundrejt Euros më 31 dhjetor do të kishte ulur ose rritur përkatësisht kapitalin dhe fitimin ose humbjen nga shumatat e treguara më poshtë. Kjo analizë është e bazuar në 5% variancë në kursin e këmbimit, që Shoqëria e parashikon të ndodhë në fund të periudhës raportuese. Në rast të një rritje apo ulje prej më shumë se 5%, nuk do të ketë penalitet shtesë. Kjo analizë supozon se të gjitha variablat e tjerë, në veçanti normat e interesit, mbeten konstante dhe nuk marrin parasysh asnjë ndikim të shitjeve dhe blerjeve të parashikuara. Analiza është kryer mbi të njëjtën bazë si për vitin 2016.

Lek	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Kapital	Fitimi ose humbje	Kapital	Fitim ose humbje
EUR	20,420,663	20,420,663	33,573,823	33,573,823

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 25. Instrumenta financiar- Vlera drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

#### (b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iv) Rreziku i tregut

Rreziku i normës së interesit

Aktivet që mbartin interesa të Shoqërisë kanë të bëjnë me llogaritë rrjedhëse në banka, prandaj të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset e mjeteve monetare operative janë në thelb të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut.

Shoqëria nuk ka detyrime me interes më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

#### Profili i rrezikut të normës së interesit

Në datën e raportimit, profili i Shoqërisë për instrumente financiare me interes ishte:

	31 dhjetor	
	2017	2016
Aktive financiare	458,189,014	838,505,228

Shoqëria nuk ka ndonjë normë të ndryshueshme të instrumentave financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

#### Analiza e ndjeshmërisë së vlerës së drejtë për instrumentet me normë fikse

Shoqëria nuk bën regjistrime në fitim ose humbje për çdo aktiv apo detyrim financiar me normë fikse në vlerën e drejtë. Kështu që një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikonte në humbje apo fitim.

Një ndryshim me 50 pikë bazë në normat e interesit do të rriste ose zvogëlonte kapitalin me 22,909,451 Lek (2016: 41,925,261 Lek).

#### Analiza e ndjeshmërisë së mjeteve monetare për instrumentet me norma variabël

Aktivet mbi të cilat llogaritet interes janë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në banka dhe si pasojë, të ardhurat dhe flukset operacionale monetare të Shoqërisë janë të pavarura nga ndryshimet e normave të interesit të tregut.

(v) Administrimi i kapitalit

Shoqëria është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar vetëm për qëllimin e implementimit të Marrëveshjes së Konçesionit. Bazuar në legjislacionin shqiptar, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar kërkohet të ketë kontribute në kapital nga ortakët por nuk ka si detyrim krijimin e rezervave ligjore. Kapitali i paguar është kontribuar nga ortakët pjesërisht në natyrë por gjithashtu dhe në para. Kapitali neto përbëhet vetëm nga 'Kapitali i regjistruar', i paguar dhe i papaguar dhe nga 'Fitimet e akumuluar'.

### 26. Angazhime, garanci dhe detyrime të kushtëzuara

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime të ndryshme nga të tretë dhe nga masa ligjore. Sipas opinionit të Drejtimit, rezultatet e këtyre çështjeve nuk do të kenë efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë apo ndryshime në aktivet neto, përveç atyre për të cilat është llogaritur një provizion në këto pasqyra financiare.

Angazhimet kapitale

Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria ka hyrë në angazhim kapital në një shumë prej 22 milionë lekësh për rinovimin dhe përforcimin e ndërtesës kryesore të zyrave. Shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të pazbatuara me 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

Pagesat e ardhshme minimale të qirasë

Më 31 dhjetor, pagesat minimale të skontuara të qirasë në bazë të qirasë operative të paanullueshme ishin të pagueshme si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Më pak se një vit	593,622	379,726
1 deri në 5 vite	-	-
Më shumë se 5 vite	-	-
	<b>593,622</b>	<b>379,726</b>

# ALEAT Shpk

## Shënime për pasqyrat financiare

(shuma në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

### 26. Angazhime, garanci dhe detyrime të kushtëzuara (vazhdim)

#### Garancitë

Në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Konçesionit, ortakët e shoqërisë kanë vënë në dispozicion të Autoritetit një garanci në formën e një Obligacioni të Performancës në shumën 10 milion Euro. Garancia zvogëlohet çdo vit në përputhje me Marrëveshjen e Konçesionit pa patur asnjë pretendim ndaj Shoqërisë. Gjatë vitit 2017, Garancia ka rënë me 250 mijë Euro. Deri më 31 dhjetor 2017, garancia është zvogëluar deri në 1.85 milion Euro.

Në përputhje me Amendimin e Kontratës së Konçesionit, kjo vlerë do të mbetet e vlefshme përgjatë të gjithë kohës së zgjatjes të termave të kontratës dhe do të zvogëlohet sipas vlerave të mëposhtme:

- a) 350 mijë Euro, brenda 30 ditëve nga lidhja e parë E-Shërbim duke përdorur platformën E-trust,
- b) 850 mijë Euro, në 1 janar 2019,
- c) 650 mijë Euro, në fund të Periudhës së Konçesionit.

Sipas Marrëveshjes së Konçesionit, në rastet kur Konçesionari nuk paguan detyrimet e përcaktuara në Marrëveshje, Autoriteti duke u bazuar në të drejtat e tij mund të përfitojë çdo shumë nga Obligacioni i Performancës, dhe Konçesionari është i detyruar t'ia paguajë Autoritetit shumën e kërkuar.

### 27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura në datën e raportimit përfshijnë:

	2017	2016
Llogari të pagueshme ndaj Idemia Identity&Security (njohur më parë si Safran Identity & Security)	37,013,170	82,127,772

Gjatë vitit Shoqëria ka kryer transaksionet e më poshtme me palët e lidhura:

	2017	2016
<i>Shpenzime:</i>		
FSHAN	306,894,475	395,629,282
Idemia Identity&Security (njohur më parë si Safran Identity & Security)	1,409,566,940	1,644,236,406
	<b>1,716,461,415</b>	<b>2,039,865,688</b>
<i>Blerje e aktiveve:</i>		
Idemia Identity&Security (njohur më parë si Safran Identity & Security)	-	398,786,160
<b>Totali i transaksioneve</b>	<b>1,716,461,415</b>	<b>2,438,651,848</b>

### Kompensimi për personelin drejtues kryesor

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Shoqëria kishte strukturën e mëposhtme të Drejtimit:

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv

Drejtori i Kontrollit Financiare

Drejtori i Cilësisë dhe Investigimit

Drejtori i Teknologjisë së Informacionit

Drejtori i Integritetit dhe Shërbimit

Drejtori i Prodhimit

Drejtori i Aplikimeve

Drejtori i Burimeve Njerëzore

Drejtori i eService

Drejtor i të dhënave të Cilësisë dhe Investigimit

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 kompensimi për personelin drejtues kryesor ishte 92,588,882 Lek (2016: 82,793,306 Lek).

### 28. Ngjarje pas datë së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së raportimit financiar e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.